

VENDIM
Nr. 311, datë 4.6.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 116, DATË 17.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË TRAJNIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 26, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 116, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm përbëhet nga anëtarë nga fusha e auditimit, të përzgjedhur nga ministri përgjegjës për financat, përkatësisht:

a) një anëtar, përfaqësues nga organizatat profesionale të audituesve të brendshëm në Shqipëri;

b) një anëtar nga fusha e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

c) një anëtar, përfaqësues nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në ministrinë përgjegjëse për financat;

ç) një anëtar nga trupa e personelit akademik në fushën e auditimit nga institucionet e arsimit të lartë;

d) një anëtar, përfaqësues nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat.”.

b) Në pikën 4 bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

i. Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Anëtarët e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm, të përzgjedhur nga fusha e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të jenë të certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik” ose ekuivalente.

ii. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) Të kenë mbi 3 (tre) vjet eksperiencë në mësimdhënie dhe/ose trajnime.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Në fund të fjalisë së pikës 6 shtohen fjalët “..., në çdo vit kalendarik”.

b) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Përfundimet e çdo mbledhjeje pasqyrohen në vendimet përkatëse dhe, së bashku me procesverbalin e mbledhjes, depozitohen në protokollin e ministrit përgjegjës për financat.”.

c) Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Komisioni i paraqet ministrit përgjegjës për financat një raport të hollësishëm mbi ecurinë dhe rezultatet e procesit në përfundim të çdo sezoni të provimeve të certifikimit të audituesve të brendshëm dhe në fund të çdo viti kalendarik.”.

ç) Shkronja “c”, e pikës 14, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Realizon të gjitha detyrat dhe merr vendime për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si dhe paraqet nevojat për ndryshime në aktet nënligjore përkatëse të ministrit përgjegjës për financat, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për të siguruar përputhshmërinë dhe përditësimin e njohurive të audituesve të brendshëm me

programin e certifikimit të audituesve të brendshëm në fuqi, si dhe me kërkesat për trajnimin e vazhdueshëm profesional.”.

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët “... dhe mbikëqyrësve ...” hiqen.

b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Mbikëqyrësit e sallave të provimeve duhet të jenë pjesë e administratës publike, të cilët caktohen nga drejtori i përgjithshëm i strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.”.

4. Kudo në përmbajtjen e vendimit bëhen këto zëvendësime:

a) Emërtimet “ministri i Financave” dhe “Ministria e Financave” zëvendësohen përkatësisht me “ministri përgjegjës për financat” dhe “ministra përgjegjëse për financat”;

b) Fjalët “... trajnim i vijueshëm profesional ...” zëvendësohen me “... trajnim i vazhdueshëm profesional ...”;

c) Fjalët “... tarifat e trajnimit ...” zëvendësohen me “... tarifat e certifikimit dhe të trajnimit të vazhdueshëm profesional ...”.

II. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku